



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 170 prot.

Kamëz, më 19.12.2024

V E N D I M
Nr. 126. Datë 19/12 2024
MBI

**“MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTAVE DHE SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR
PROGRAMIN "PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË
VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA" PËR VITIN 2025”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.12.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.95 Datë 13.12.2024 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar; Vendimit nr. 454, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe proedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkurruese për programin e përmirësimit të kushteve ekzistuese”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimi të Ministrisë së financave dhe Ekonomisë me nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së dokumentave dhe sistemin e pikëzimit për programin e **“Përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”**.
2. Mënyra e vlerësimit dhe llogaritjes të sistemit të pikëzimit do të bëhet sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Lista e dokumentave do të jetë sipas Aneksit nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të ngarkojë Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit si dhe Sektorin e Strehimit për ndjekjen dhe zbatimin e gjithë procedurës.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

